TFL
TOGETHER FOR LIFE


Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri
AWEN

Suedi
Sverige

Skenari: ALMA LAHE

Piktor: KOSTA RAKA

Vajza nuseron, djali trashëgon



Ky material është plotësisht i financuar nga Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri - AWEN, nëpërmjet fondeve të Agjencisë Ndërkombëtare për Zhvillim dhe Bashkëpunim - Sida. AWEN dhe Sida nuk janë domosdoshmërisht dakord me opinionin e shprehur. Vetëm "Together for Life" është përgjegjës për përmbajtjen.

Në një vend të lirë dhe të zhvilluar, prona konsiderohet si një nga drejtat themelore të njeriut. Shqipëria, si një vend aspirant për të qenë pjesë e Bashkimit Evropian, ka ndërmarrë një sërë reformash që përfshijnë edhe garantimin e drejtës së pronës, siguruar përmes një sistemi të rregulluar e të harmonizuar të pasurive të paluajtshme, që ofron tituj të qartë e të sigurt pronësie për këdo. Por, në praktikë, kjo e drejtë nuk gjen zbatim të barabartë si për burrat edhe për gratë. Ndodh që të afërmit, familjarët ose autoritetet shëndetësore t'u cenojnë vajzave dhe grave të drejtat mbi pronësinë, duke u kërkuar të heqin dorë nga prona, ose duke i mashtruar, shantazhuar apo dhunuar.

Kultura zakonore, sipas të cilës e drejta mbi pronësinë i njihet vetëm linjës mashkullore në familje, vazhdon të mbizotërojë mbi të drejtën e garantuar me Kushtetutë dhe Ligj.

Edhe pse ligjet në Shqipëri e garantojnë të drejtën e pronës për të gjithë shtetasit, zbatimi i dobët i ligjit për regjistrimin e pasurive të paluajtshme dhe tradita patriarkale që favorizon djemtë në trashëgiminë e pronave familjare ka krijuar një hendek të thellë gjinor, duke i bërë gratë shqiptare të jenë të varura ekonomikisht gjatë gjithë jetës së tyre.

Gruas i mohohet e drejta mbi pronësinë, si në familjen e prindërve, ashtu edhe në familjen e re që krijon me bashkëshortin. Shpesh gruaja është e detyruar të bashkëjetojë brenda një martese të palumtur ose të dhunshme sepse divorci do ta nxirrte në rrugë.

Ndërgjegjësimi i grave për të kërkuar të drejtat që u njeh ligji mbi pronën është detyrë e të gjithëve.

TOGETHER FOR LIFE

Rr. Brigada VIII, Pallati jeshil Tekno-Projekt.
Shk.2, Ap.13, Tiranë


info@togetherforlife.org.al

www.togetherforlife.org.al


Me trashëgime e jetë të lumtur çiftit!
1
Hajde, me trashëgime, çifti!
2
Të na trashëgohesh, moj bijë, dhe mos na turpëro! Që këtej e tutje shtëpia dhe nderi yt është tek burri.
Qofsh e lumtur, motër!
3


NË SHTËPINË E RE







NË SHTËPINË E PRINDËRVE




Pupuuu, ç'janë këto që thua, moj bijë?
Se mos është shtëpia ime atje. Kjo është shtëpia ime.
Gabohesh, moj vajzë! Ti nuk ke më shtëpi këtu, por tek burri yt.
9
Mirëdita, motër! Si jeni? Astritin si e kam?
Mirë se erdhe, vëlla! Mirë jemi.
10

Bëre mirë që erdhe, motër. Më duhet një prokurë prej teje, sepse po ndjek në kadastër e gjykatë çështjen e pronave të babait. Dhe ky angazhim, tashmë, më ka mbetur mua si barrë.

Meqë është fjala për pronat e babait, do ta jap prokurën.



11

NOTERI

Urdhëroni! Sipas porosisë së prindërve e vëllait tuaj, deklaratën noteriale e kam gati. Ju lutem, më jepni kartën e identitetit...




12


NOTERI
Nuk kemi kohë, motër, firmose të ikim.
Urdhëro, firmoseni në fund, ku keni emrin tuaj...
Ta lexoj një herë...
13
Ja dhe kjo punë u krye...
14
15


Më kanë gënjyer vëllai dhe prindërit. Para 3 vitesh më çuan tek noterja t'i jepja vëllait një prokurë për të ndjekur çështjen e pronave të babit, por...
Përse je e mërzitur?
E pastaj?
16
Më vunë e firmosa një dokument pa lexuar. tani mësova që dokumenti ishte një deklaratë me të cilën unë "i dhuroja" vëllait pjesën e shtëpisë dhe pasurisë që më takonte nga prindërit.
17
Epo, mos gabosh dhe për shtëpinë që po blen me Astritin, pasi të dy jeni bashkëpronar.
18

15 VITE MË PAS




Ëhë, tani po e kuptoj pse kur blemë shtëpinë, ngulje këmbë që ta regjistronim në emrin e të dyve. Parashikoje këtë ditë...
Jo! Divorci është për fajin tënd, ndërsa shtëpia është kontributi i të dyve.
22
Për hatër të fëmijëve e fala disa herë, por kohët e fundit ishte bërë dhe i dhunshëm. Nuk mund të duroja më.
Mos u mërzit, shoqe! Ti u përpoqe ta shpëtosh familjen tënde!
Ke të drejtë. Jeta nuk mund të shtyhet me dhunë e tradhti.
23

Nuk besoj se të hapi probleme për pronësinë e banesës?

Jo, avokati ia bëri të qartë që prona është e përbashkët dhe të dy kemi njësoj të drejta mbi të. Pas divorcit do të bëjmë një seancë për ndarjen e pasurisë. Nuk kemi më arsye për t'u konfliktuar. Edhe fëmijët janë më të qetë.



24

Drejtësia iu fal qetësi të gjithëve, shoqe. Të dy jeni "të fituar" nga zgjidhja e çështjes së pronësisë, por mbi të gjitha u keni shmangur fëmijëve një ankth që mund t'u kushtonte edhe të ardhmen.



25

Piktor: Kosta Raka

Shoqata Together for Life me mbështetjen e AWEN (Rrjeti i fuqizimit të gruas në Shqipëri) po zbaton projektin me titull "Kanuni përballë Ligjit" që synon informimin publik për të drejtën e grave në trashëgimi. Qëllimi i fushatës është të sensibilizoj popullatën, me theks të veçantë gratë që jetojnë në zonat rurale, për të drejtat e grave në trashëgimi si një nga çështjet më problematike kur bëhet fjalë për qasjen e grave në pronë.

Ky material është plotësisht i financuar nga Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri – AWEN, nëpërmjet fondeve të Agjencisë Ndërkombëtare për Zhvillim dhe Bashkëpunim – Sida.

AWEN dhe Sida nuk janë domosdoshmërisht dakord me opinionin e shprehur. Vetëm 'Together for Life' është përgjegjës për përmbajtjen.

TOGETHER FOR LIFE

Rr. Brigada VIII, Pallati jeshil Tekno-Projekt.

Shk.2, Ap.13, Tiranë

info@togetherforlife.org.al

www.togetherforlife.org.al